



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/27

Datë: 30.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 95, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, të nenit 3, paragrafi 1, i Udhëzimit Administrativ QRK - Nr. 06/2018 për Zbatimin e Proceduarve Qendrore të Prokurimit Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndryshimi i listës së artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik, e bashkangjitur në Shtojcën e këtij Vendimi.
2. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të bëjnë shpalljen e këtij vendimi sipas nenit 95, paragrafi 2, i Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
3. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojcë
Artikujt dhe shërbimet që janë pjesë e prokurimeve të përbashkëta

Nr.	Përshkrimi	Lloji i Kontratës	Kohë zgjatja në vite
1	Furnizimi me letër për kopje	Kornizë	3
2	Furnizimi me material zyrtar	Kornizë	3
3	Furnizimi me goma për automjete	Kornize	3
4	Furnizimi me vetura te udhëtareve	Kornizë	3
5	Furnizim me artikuj ushqimor	Kornizë	3
6	Furnizim me mobile	Kornizë	3
7	Furnizim me TI (Teknologji Informative)	Marrëveshje	3
8	Furnizim me pemë dhe perime	Marrëveshje	3
9	Marrja me qira e veturave të udhëtareve	Kontratë afatgjate	6
10	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi- me qira	Kontratë afatgjate	6
11	Furnizim me karburante	Kornizë	3
12	Furnizim me Mazut	Kornizë	3
13	Shërbime transport ajror	Kornizë	3
14	Furnizimi me ujë të pijes	Kornizë	3